



**Data: 29.01.2025**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**“Rehabilitimi Qëndres Inovative dhe Kreative për fëmijë "Thoma Turtulli", Korçë (faza e I-rë).”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Punime ndërtimi 45210000-2

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**15.014.647(pesëmbëdhjetë milion e katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë)lek,pa tvsh.**

Kjo kontratë financohet nga SECO dhe MIE bazuar në Marrëveshjen kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran “Për Bashkëpunimin teknik,financiar dhe humanitar” të lidhur në datën 11.05.2007 dhe e ratifikuar me Ligjin Nr 9801 datë 13.09.2007“, Marrëveshjen datë 12.11.2021 “Mbi dhenien e asistencës teknike dhe financiare në kuadrin e “Projektit të Bashkive me Energji Inteligjente”(SEMP),të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Konfederatës Zvicerane, Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Korçë dhe Sekretariatit të Shteti Zviceran për Çështjet ekonomike (SECO) “Për zbatimin e projektit për bashkitë me shfrytëzim inteligjent të energjisë (SEMP)” dhe Ndryshimi Nr 1 datë 18.04.2024 i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Korçë dhe Sekretariatit të Shteti Zviceran për Çështjet ekonomike (SECO) “ Për zbatimin e projektit bashki me energji inteligjente (SEMP) ”.

Bashkëfinancim i detajuar si më poshtë:

*Kontribut i SECO- 15.014.647 lekë,pa tvsh*

*Kontribut nga MIE- MIE do të financojë TVSH-në në vlerën 3.002.929 lekë.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA KORÇË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.1. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1.1** 2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021,2022,2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

---

*Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogel se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet. që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

---

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."*

---

**2.1.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021,2022,2023**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se "4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vjetët e fundit financiarë, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit."*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës **31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me*

*përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

## **2.2Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.2.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50 %** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit** të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

### **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :**

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

### **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten :**

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

*-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.*

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se vlera totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

**Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Lidhur me dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e punëve të ngjashme janë kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: “**Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.**

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruar në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”**

Në kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit apo marrëveshjes së nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit

leshuar nga Institucioni. Dokumenta keto te nevojshme per te vleresuar lidhur me punet konkrete qe ka kryer OE si anetar i BOE,apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

*Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme*

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

#### **Kategoria    Klasifikimi    Emertimi i kategorise**

N.P – 3	A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
N.S – 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S - 12	A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
N.S – 14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të MinistraveNr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridik që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar,*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive			Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse		
N.P – 3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	<b>2.Punime catie dhe izolimi</b>	A0-20 milionë lekë			Vlera e punimeve të parashikuara		
		2/219	Ndertim cati me tjegulla importi + h/izolim e zhvilluar	m2	345	3826.7	1,32	
		2/203/a	F,V impjuve bakri	m2	39.6	2505.28	9	
		2/212/b	F.V ulluk horizontal bakri	ml	66	2015.74	19	
		2/209/b	F.V ulluk vertikal bakri	ml	23	2618.57	6	
		2/196/c	Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cimentoPregatitur nga dy komponente A + B	m2	191	1627.75	48	
		An	Tavan me veshje gipsi akustik ( Clineo ) + lesnguri ( kati perdhe)	m2	229.2	4949.67	1,13	
		An	Veshje mure me material temoizolues t=5cm	m2	352.5	1510.02	53	
		An	Veshje muri me knauh me 1 shtrese	m2	352.5	1399.4	49	
			<b>Shuma 2</b>					<b>4,32</b>
			<b>3.Punime Shtresash</b>					
		2.276	Shtrese parketi inxhinjerrik kati perdhe	m2	229.2	7217.91	1,65	
		2200	Shtresë llustër çimento 1:2 t=2cm	m2	231.3	503.35	11	
		2.267b	Shtrese me pllaka grez importi (60x60 ) cm katinentoke	m2	231.3	3,218	74	
		2.324/b	Fv Plintuse grez importi, h = 10 cm	ml	174	387.8	6	
			<b>Shuma 3</b>					<b>2,58</b>
			<b>4. Punime suvatimi,veshje e bojatisjeje</b>					
		2.328	Patinim muri allci ( stuko )	m2	352.5	384	13	
		2.33	Patinim tavani allci ( stuko)	m2	229	565	12	
		2.404	Lyerje mure Boje hidroplastike	m2	630	238.38	15	
		2/326	Veshje muri me pllake majolike banjo	m2	42	2,809	11	
			<b>Shuma 4</b>					<b>53</b>
			<b>5.Punime dyer dhe dritare</b>					
		2.388/1	V F dyer druri te brendeshme te rimesuara	m2	27.5	13,986	38	
		2.395/1	F.V dyer te jashtme druri dopjo xham	m2	9.4	16,097	15	
		2.375/1	F.V dritare duroplast dopjo xham	m2	82.3	15,496	1,27	
		2/272	Pragje mermeri dritare	m2	23.3	5,401	12	

		2/394/a	F.V grila druri ( grila kanata druri)		m2		60.7	15,975	96	
		2/373	F.V vetrare druri kati per dhe		m2		21.2	8,982.52	19	
			<b>Shuma 5</b>						<b>3,09</b>	
		<b>6.Punime hidroizolim themeli</b>								
		2/522	F.V tubo plastike per drenazh d=160m/m		ml		33	2012.26	6	
		2.338	Pusete shkarkimi 40 x40 x 100 cm		cop e		1	15380.78	1	
		2--1	Germim dheu me krah per drenazh		m3		16.5	1368.65	2	
		An	Izolim themeli me material hidroizolues		m2		33	340.24	1	
		3.396	Mbushje me cakull pas mureve ( drenazh)		m3		16.5	1049.42	1	
			<b>Shuma 6</b>						<b>13</b>	
N.S- 1	Punime për prishjen e ndërtimeve.	<b>1.Punime Prishje</b>			<b>A, 0-20</b>		Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion			
		2.208/1	Hegje ulluk shkarkimi vertikal	milionë lekë						
		2.208/2	Hegje ulluk shkarkimi horizontal	ml						
		2/370/1	Hegje dyer dritare ( komplet )	m2						
		2.566	Prishje tavan me gips ( komplet )	m2						
		2.430/2	Prishje cati ekzistuese e zhvilluar	m2						
		An	Hegje pragje ekzistues ( komplet )	m2						
		2/281	Hegje pllaka dyshemeje + muri ( kati nentoke)	m2						
		2.263	Hegje dysheme druri	m2						
		2/37/5 b	Transport materiale 10km	m3						
N.S-12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.	An	F.V panel diellor per ujin sanitar	A, 0-20 milionë lekë		Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion				



N.S-14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	4.131/3.7	F.V.ne toke kablo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesë plastmasi, te armuar, 4x25mm <sup>2</sup>	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
		4.155/5	F.V. kuti shperndarese me kapak metalike 91x91x54mm		
		<b>Shuma 1:</b>			
		2.481/1	F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm <sup>2</sup>		
		2.481/2	F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm <sup>2</sup>		
		2.480/1	F.V tub plastmasi Ø 14-17mm		
		2.480/2	F.V tub plastmasi Ø 18-21mm		
		2.480/3	F.V tub plastmasi Ø 22-26mm		
		2.480/4	F.V tub plastmasi Ø 27-30mm		
		2.480/5	F.V tub plastmasi Ø 31-36mm		
		2.487/a	F.V kuti suport pllaket 2 mod		
		2.487/b	F.V kuti suport pllaket 4 mod		
		2.485/d	F.V priza shuko universal		
		2.485/1	F.V Çeles 1 polar 220V 10A		
		2.485/4	F.V Çeles 2 polar 220V 10A		
		2.487	F.V Kutiderivacioni plastm		
		2.551	F.V. Sirene e jashtme		
		2.550	F.V. Sirene e brendshme audio vizive		
		2.503	F.V. Percjelles shirit Zn 30x3mm		
		2.465	F.V. Ndricules tip plafoniere, emergjence, 1x18ë, IP65		
		2.481/4	F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm <sup>2</sup>		
		2.473	F.V. Ndricules evakuimi me llampe 1x11W, IP40		
		<b>Shuma 2:</b>			
		3.182	FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm		
		3.176	FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086		
		<b>Shuma 3:</b>			
		An1	F.V. Koka kabllore me kapikorda&terminale; 4x(16÷25) mm <sup>2</sup>		
		An2	F.V. Kablo fuqie Cu, ÷1000V, me izolim PVC, 4x16 mm <sup>2</sup>		
		An3	Tub plastmasi te brinjezuar me muftë ø80		
		An4	F.V. Kuadri elektrik, komp. me kit zbarra 50A & aksesore, 54 module, IP40, aprox.dim.400x550x130mm, perfshire te gjithë dispozitivet sipas skemes elektrike ne fletet e projektit elektrik.		
		An5	F.V. Kuadri elektrik, komp. me kit zbarra 32A & aksesore, 36 module, IP40, aprox.dim.400x400x130mm, perfshire te gjithë dispozitivet sipas skemes elektrike ne fletet e projektit elektrik.		
		An6	F.V. Kablo Cu per ndriçim, te izoluar me gome, 3x2.5mm <sup>2</sup>		

		An7	F.V. Kablo fuqie Cu, ±1000V, me izolim PVC, Tip FG70-R, S =3x1.5 mm <sup>2</sup>		
		An8	F.V. Kuti ne dysHEME [2x(2P+T) 16A, Un=250V, 1xRJ45]		
		An9	F.V. Ndricues tavani LED 30±36W ø60cm, 220V		
		An10	F.V. Ndricues tavani LED 30±36W ø30cm, 220V		
		An11	F.V. Ndricues tavani LED 30±36W ø90cm, 220V		
		An12	F.V. Ndricues spot tavani tip LED ±11ë, 220V		
		An13	F.V. Ndricues tavani i varur LED ±32ë, 125x1175mm, 220V		
		An14	F.V. Kablo rrjeti LAN, Tip FTP-cat6e		
		An15	F.V. Priza kompjuterike, TIP RJ - 45 cat6e		
		An16	F.V. RACK, 42 HU dim.800x800mm Stand Alone me mundesi kontrolli		
		An17	F.V. Patch corda me FTP-cat-6e me dy koka konektoriale, l-1.5m		
		An18	F.V. Sëitch me 24 porta RJ-45, FTP cat 6e		
		An19	F.V. Grup ventilatoresh me 2 Fan/rack		
		An20	Set 8 schuko/rack		
		An21	F.V. Central zjarri i adresueshem, 230V/12V, 24h/autonomi		
		An22	F.V. Kabell me izolim PVC, tip RG-59, S=2x1mm <sup>2</sup> , red colour		
		An23	F.V. Dedektor tymi&nxehtesie; te adresuar, optik-jonik-termik OH 320 C		
		An24	F.V. Pulsant alarmi me thyerje xhami		
		An25	F.V. Morseta, suporte me bulon, kapje e mberthimi per St/tZn 30x3mm		
		An26	F.V. Çeles dedektor per ndrçimin		
		An27	Dalje ndrçimi 3x1.5mm <sup>2</sup>		
		An28	F.V. Ndricues tavani i varur LED ±30W, 220V		
		An29	F.V. Shtiza me maje te zingura St/tZn d=16 mm ; L=1ml		
		An30	F.V. NVR (Netëork Video Recorder) 24 Channels me 24 porta PoE		
		An31	F.V. Kamera sigurie IP 8MP WDR, tipi "Bullet"		
		An32	F.V. Hard Drive 2TB		
		An33	F.V. Kabell rrjeti FTP cat5e per kamerat		
		An34	F.V. SoftWare menaxhim sistemi		
		An35	F.V. Ndricues Led spot i jashtem mbi siperfaqe 10 W		

**2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencen profesionale te shoqerise, te vlefshme per zbatimin e punimeve objekt kontrate, te leshuar nga Ministria e Kultures.**

N-Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, VKM Nr 792 datë 07.10.2020 “Per percaktimin e kushteve dhe te kritereve te posacme te licencimit,dokumenteve shoqeruese,nenkatgorive te licencave, procedurave per dhenien,pezullimin ose revokimin si dhe kuotizacionit vjetor te licencave epr nderhyrjet ne pasurite kulturore materiale” i ndryshuar dhe ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar.*

**Kjo licence eshte kerkuar per arsye se bazuar ne VKM Nr 207 date 15.03.2017 “Per shpalljen e qendres historike te qytetit te Korces dhe miratimin e rregullores per mbrojtjen,konservimin e integruar dhe administrimin e saj e te zones se mbrojtur perreth”, objekti ku do te nderhyet ndodhet brenda kufirit te qendres historike te Korces.**

**2.2.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1(një)

*Per te vertetuar personelin kryesor duhet:*

*I.diploma*

*II- kontrata e punes*

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij*

neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj”, VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivitetit dhe të grafikut të punimeve.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin kryesor të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Konkretisht:**

**Kerkesa per drejtuesin teknik “Inxhinier Ndertimi”** Eshte vendosur duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar,pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier,Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.

Bazuar ne zerat e punimeve te parashikuara ne preventiv, ,nevojitet nje drejtues teknik me profesion ing ndertimi i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

Kerkesa per **Inxhinier Elektrik** është vendosur për asye se ne preventiv jane parashikuar punime elektrike, per kete arsye nevojitet nje drejtues teknik me profesion ing elektrik i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve elektrike , në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

**2.2.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **19 persona**, dokumentuar kjo me Vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**2.2.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Sasia</b>	<b>Pronesia</b>
Kamion me kapacitet mbartës deri në 5 -10 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Kamioncine me kapacitet mbartës deri në 3 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Auto vinc	Cope 1	ne pronesi ose me qira

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

Per mjetet qe jane ne pronesi duhet te paraqitet, certifikata e pronesise , leja e qarkullimit,certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

Kur jane me qera te paraqiten: kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit ,certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

(Ne rastin e mjeteve te marra me qira nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 , referuar dokumentacionit ( leje qarkullimi,çertifikate e transportit te mallrave ) , mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

**Argumentimi kriteret 2.2.5 dhe 2.2.6:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“ dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se „Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: „mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.“

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe gjithashtu edhe bazuar edhe në rekomandimin e APP Nr 1797/1 datë 10.03.2022 janë parashikuar orët e punës për secilin zë punimesh dhe bazuar edhe në afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve është përcaktuar numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve.

Numri i fuqisë punëtore është llogaritur në baze të zberthimit të grafikut të punimeve, zberthimit të preventivit dhe natyrës së objektit, numri prej 19 personash përfshin personelin kryesor drejtues teknik, staf mbështetës, specialiste+punëtorë të përlllogaritur nga zberthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

**Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushës rezulton se :**

Sasia totale e oreve të punës sipas manualit dhe analizave teknike për çdo zë të preventivit është **9339** ore. Llogaritja e numrit të punonjësve në varesi të oreve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë:

<i>Totali orë pune + orë makineri</i>	<b>9339</b>
<i>Ditë pune (orë pune/8)</i>	<i>1167</i>
<i>Specialiste+punetore per 3 muaj (60 dite pune)</i>	<i>17</i>
<i>Ing. ndërtimi</i>	<i>1</i>
<i>Ing. hidroteknik</i>	<i>1</i>
<i>Numri i punëtorëve gjithsej</i>	<b>19</b>

**Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:**

*Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyrën dhe volumnin e punimeve të parashikuara në preventiv .*

*Gjithashtu bazuar në nenin 28 të Udhezimit Nr.15, datë 24.7.2007 "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR"i ndryshuar, "Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit."*

<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Sasia</b>	<b>argumentimi</b>
Kamion me kapacitet mbartës deri në 5 -10 ton	Cope 1	Per transportimin e materialeve per prishjen dhe ndertimin e catise .
Kamioncine me kapacitet mbartës deri në 3 ton	Cope 1	Per transportimin e materialeve te tjera ndertimore
Auto vinc	Cope 1	Per ngjitjen e tjegullave dhe lendes ne cati.

**Argumentimi i specifikimeve teknike**

Dokumentacioni teknik ku përfshihen Specifikimet Teknike,Projekti, Preventivi dhe Grafiku i Punimeve për këtë objekt janë dorëzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës , pjese perberese e struktures se Bashkise Korçë, në përputhje me detyrat e saj funksionale.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën

dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar).

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi , burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjate hartimit te specifikimeve teknike jane marre ne konsiderate kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese të përcaktuara në aktet në ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili eshte publikuar sebashku me dokumentat e tenderit.

## **NJESIA E PROKURIMIT**